

*E përkthyer nga gjuha maqedone

MENAXHIMI I IPA-s

Komisioni është përgjegjës për zbatimin e Rregullores së IPA-s. Sipas kësaj Rregulloreje, aktivitetet menaxhohen, monitorohen, vlerësohen dhe raportohen në përputhje me Rregulloren (KE, Euratom) Nr. 1605/2002, e cila është Rregullorja Financiare e KE-së.

Në përputhje me Rregulloren Financiare, menaxhimi i ndihmës (IPA) mund të zbatohet përmes:

- menaxhimit të centralizuar,
- menaxhimit të përbashkët ose menaxhimit të decentralizuar,
- menaxhimit të përbashkët me organizatat ndërkombëtare.

Financimi i Komunitetit mund të zbatohet përmes marrëveshjeve të financimit midis Komisionit dhe vendit përfitues, kontratave të prokurimit ose marrëveshjeve të granteve me organe kombëtare ose ndërkombëtare të sektorit publik, ose me persona fizikë ose juridikë përgjegjës për zbatimin e veprimit, ose përmes kontratave të punësimit. Për programet ndërkufitare me Shtetet Anëtare, detyrat e zbatimit mund t'u delegohen Shteteve Anëtare dhe në atë rast ato zbatohen përmes menaxhimit të përbashkët/të ndarë.

Çdo vit, Komisioni i paraqet Parlamentit Evropian dhe Këshillit të Evropës një raport mbi zbatimin e asistencës, i cili përmban informacion mbi aktivitetet e financuara gjatë vitit dhe mbi gjetjet e monitorimit, duke dhënë një vlerësim të rezultateve të arritura në përdorimin e fondeve.

Komitetet

Rregullorja IPA krijon një Komitet IPA të përbërë nga përfaqësues të Shteteve Anëtare, dhe të kryesuar nga një përfaqësues i Komisionit. Ai ndihmon Komisionin në detyrën e tij për të siguruar koordinimin dhe koherencën e ndihmës sipas komponentëve të ndryshëm, d.m.th. e ndihmon atë në miratimin e dokumenteve shumëvjeçare të planifikimit tregues dhe revizioneve të tyre vjetore, si dhe programeve të ndihmës.

Komisioni gjithashtu miraton programe zhvillimi rajonal me ndihmën e Komitetit Koordinues të Fondeve. Komisioni ndihmohet në miratimin e programeve sipas komponentit të zhvillimit rural nga Komiteti i Zhvillimit Rural.

Programet (programet shumëvjeçare dhe vjetore) mund të ndryshohen, me kusht që ato të mos sjellin ndryshime thelbësore në natyrën e programeve dhe aktiviteteve origjinale dhe, sa i përket elementit financiar, kur ato nuk tejkalojnë 20% të shumës totale të parashikuar për programin ose për aktivitetin e lartpërmendur, deri në një maksimum prej 4 milion eurosh. Komiteti që jep mendimin mbi programin ose operacionin origjinal duhet të informohet për çdo vendim në lidhje me ndryshimet.

Llojet e ndihmës

Ndihma, në përputhje me këtë Rregullore, mund të financojë, ndër të tjera, investime, kontrata prokurimi, grante, duke përfshirë subvencione të normës së interesit, kredi speciale, garanci kredish dhe ndihmë financiare, mbështetje buxhetore dhe forma të tjera specifike të mbështetjes buxhetore dhe kontribute në kapitalin e institucioneve financiare ndërkombëtare ose bankave rajonale të zhvillimit.

Fondet IPA nuk do të përdoren për të paguar taksa, detyrime ose tarifa në vendet përfituese.

Masat mbështetëse

Ndihma mund të përdoret gjithashtu për të mbuluar kostot e aktiviteteve që lidhen me përgatitjen, ndjekjen, kontrollet, auditimet dhe vlerësimet e nevojshme për menaxhimin e programit dhe arritjen e objektivave të tij, në veçanti studimet, takimet, informacionin dhe publicitetin, si dhe kostot e tjera të asistencës administrative dhe teknike nga të cilat Komisioni mund të përfitojë në menaxhimin e programit.

Zbatimi i ndihmës

Komisioni dhe vendet përfituese do të lidhin marrëveshje kornizë për zbatimin e ndihmës.

Më 30.10.2007, Qeveria e Republikës së Maqedonisë nënshkroi Marrëveshjen Kornizë me Komisionin Evropian, e cila u ratifikua nga Parlamenti i Republikës së Maqedonisë në janar 2008. Marrëveshja Kornizë përcakton rregullat për bashkëpunim në lidhje me ndihmën financiare të KE-së në kuadër të zbatimit të ndihmës në kuadër të IPA-s.

Marrëveshje shtesë në lidhje me zbatimin e ndihmës do të lidhen midis Komisionit dhe vendit përfitues (marrëveshje sektoriale).

Ndihma sipas Rregullores IPA mund të përdoret nga vendi përfitues pasi marrëveshja kornizë dhe, nëse është lidhur, marrëveshja sektoriale për komponentin të jenë lidhur dhe të kenë hyrë në fuqi.

Marrëveshja Kornizë e lidhur nga Republika e Maqedonisë me Komisionin Evropian përcakton:

(a) rregullat e përgjithshme për ndihmën financiare të Komunitetit,

(b) krijimin e strukturave dhe organeve të nevojshme për menaxhim,

(c) përgjegjësitë e përbashkëta të strukturave, organeve dhe autoriteteve të lartpërmendura,

(d) kërkesat dhe kushtet e kontrollit për:

(i) akreditimin dhe monitorimin e akreditimit të koordinatorit nacional autorizues nga koordinatori kompetent i akreditimit,

(ii) akreditimin dhe monitorimin e akreditimit të strukturës operative nga koordinatori nacional autorizues,

(iii) delegimin e kompetencave të menaxhimit nga Komisioni,

(e) hartimin e një deklarate vjetore sigurie nga koordinatori nacional autorizues,

(f) rregullat e prokurimit,

(g) mbylljen e programeve,

(h) përkufizimet e parregullsisë, mashtrimit dhe korrupsionit aktiv dhe pasiv, në përputhje me ato të legjislacionit të Komunitetit; detyrimin e vendit përfitues për të marrë masa mbrojtëse të përshtatshme

kundër korrupsionit aktiv dhe pasiv, masave kundër mashtrimit dhe veprimeve korrigjuese; dispozitat mbi rikuperimin në rast të parregullsive ose mashtrimit,

(i) rikuperimet dhe korrigjimet dhe rregullimet financiare,

(j) rregullat mbi mbikëqyrjen, kontrollin dhe auditimin nga Komisioni dhe Gjykata Evropiane e Auditorëve;

(i) dispozitat mbi taksat, detyrimet doganore dhe tarifatat e tjera fiskale, (j) kërkesat për informacion dhe publicitet.

Për komponentin e pestë të IPA-s, pra Komponentin e Zhvillimit Rural, Republika e Maqedonisë përfundoi një Marrëveshje Sektoriale për zbatimin e Programit për Zhvillimin e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (Programi IPARD) në bazë të menaxhimit të decentralizuar pa kontroll ex ante.

Kriteret e akreditimit

Para se të vendoset për dhënien e kompetencave të menaxhimit (menaxhimi i decentralizuar) në lidhje me një komponent, program ose masë të një vend përfitues, Komisioni duhet të sigurojë që vendi përkatës të përmbushë kushtet e kërkuara në lidhje me sistemet e menaxhimit dhe kontrollit në vend.

Për këtë qëllim, strukturat, autoritetet dhe organet duhet të vendosin kontrolle efektive në fushat e mëposhtme si kritere bazë për akreditim:

1. Mjedisi i kontrollit (krijimi dhe menaxhimi i organizatës dhe stafit)

2. Planifikimi/menaxhimi i riskut

3. Aktivitetet e kontrollit

4. Aktivitetet e monitorimit

5. Komunikimi (shkëmbimi i informacionit midis të gjithë pjesëmarrësve).

Në vitin 2009, strukturat dhe dhënien e kompetencave për menaxhimin e decentralizuar të fondeve IPA u akredituan nga Komisioni i Republikës së Maqedonisë për Komponentët III, IV dhe VI të IPA-s. Për Komponentin IIPA, i cili ka fondin më të madh të fondeve në dispozicion dhe që ka të bëjë me promovimin dhe zhvillimin e institucioneve në Republikën e Maqedonisë, transferimi i menaxhimit u transferua në vitin 2010. Fondet nga ky komponent janë përdorur edhe para miratimit të një mënyre të menaxhimit të decentralizuar (domethënë të centralizuar përmes Delegacionit të BE-së në Shkup).

Mbrojtja e interesave financiare të Komunitetit

Çdo marrëveshje që rrjedh nga kjo Rregullore duhet të përmbajë dispozita që garantojnë interesat financiare të Komunitetit, veçanërisht në lidhje me mashtrimin, korrupsionin dhe çdo parregullsi tjetër. Hetimet për mashtrim do të kryhen nga Zyra Evropiane Kundër Mashtrimit (OLAF). Kontrollat dhe inspektimet në vend do të kryhen nga Komisioni me qëllim mbrojtjen e interesave financiare të Komuniteteve nga mashtrimet dhe parregullsitë e tjera.

Marrëveshjet duhet të parashikojnë që Komisioni dhe Gjykata e Auditorëve do të kenë fuqinë e auditimit, në bazë të dokumenteve dhe në vend, mbi të gjithë kontraktorët dhe nënkontraktorët që kanë marrë fonde të Komunitetit. Ato gjithashtu parashikojnë që Komisioni të ketë akses urgjent për të kryer kontrole në vend, si dhe inspekte.

Rregullat mbi pjesëmarrjen dhe origjinën, të drejtën për grante

Të gjithë personat fizikë që janë shtetas të Shteteve Anëtare ose të gjithë personat juridikë të vendosur në Shtetet Anëtare, një vend përfitues i kësaj Rregulloreje, një vend përfitues i Instrumentit Evropian të Fqinjësisë dhe Partneritetit ose një Shtet Anëtar i Zonës Ekonomike Evropiane kanë të drejtë të marrin pjesë në kontratat e prokurimit ose granteve të financuara sipas kësaj Rregulloreje.

Në përputhje me Nenin 114 të Rregullores (KE, Euratom) Nr. 1605/2002, personat fizikë mund të marrin grante.

Koherenca, përputhshmëria dhe koordinimi

Programet dhe projektet e financuara sipas kësaj Rregulloreje duhet të jenë në përputhje me politikat e BE-së. Ato duhet të jenë në përputhje me marrëveshjet e lidhura midis Komunitetit dhe Shteteve të tij

Anëtare, me vendet përfituese dhe duhet të respektojnë detyrimet që rrjedhin nga marrëveshjet shumëpalëshe të cilat i kanë nënshkruar.

Komisioni dhe Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë koherencë dhe koordinim midis ndihmës së Komunitetit të ofruar sipas kësaj Rregulloreje, dhe ndihmës financiare të ofruar nga Komuniteti dhe Shtetet Anëtare përmes instrumenteve të tjera financiare të brendshme dhe të jashtme dhe ndihmës së ofruar nga Banka Evropiane e Investimeve.

Ndërprerja e ndihmës

Respektimi i:

- parimeve të demokracisë,
- sundimit të ligjit dhe të drejtave të njeriut dhe të pakicave,
- dhe lirive themelore.

është një element thelbësor për zbatimin e kësaj Rregulloreje dhe për ofrimin e ndihmës në përputhje me të.

Nëse një vend përfitues nuk i respekton këto parime ose angazhimet e përfshira në partneritetet përkatëse me BE-në, ose nëse progresi në përmbushjen e kriterëve të pranimit është i pakënaqshëm, Këshilli, me propozim të Komisionit, mund të ndërmarrë hapa të përshtatshëm në lidhje me çdo ndihmë të ofruar sipas kësaj Rregulloreje. Parlamenti Evropian do të informohet plotësisht dhe menjëherë për çdo vendim të marrë në këtë kontekst.

Vlerësimi

Komisioni do të vlerësojë rregullisht rezultatet dhe efikasitetin e politikave dhe programeve dhe efektivitetin e programimit, me qëllim që të përcaktojë nëse objektivat janë përmbushur dhe për të mundësuar formulimin e rekomandimeve me qëllim përmirësimin e operacioneve të ardhshme. Hartimi i programit dhe ndarja e burimeve/fondeve do të varen nga këto rezultate.

Në përputhje me Rregulloren (KE) Nr. 718/2007 të 12 qershorit 2007, për zbatimin e Rregullores së Këshillit (KE) Nr. 1085/2006 për themelimin e IPA-s

Instrumenti i paraanëtarësimit për Zhvillimin Rural - Programi i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural